



Pranuar / Dorezuar Prijeto / Prodato Received / Delivery	24.02.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtytja Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTICK	2122/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1299/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1299/2022 të datës 08.12.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*Kërkesë nga marrëdhënia e Punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.1299/2022 e datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGOHET Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke lëshuar Akt emërimin për ankuesin sipas Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

III. OBLIGOHET Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin për pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nga data 06.08.2022 deri në nxjerrjen e Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi duke bërë kompensimin e pagave për ankuesin nga data 08.11.2022, deri në zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Sipas Vendimit A.nr.741/2022 të datës 21.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 08.11.2022 ka nxjerr Vendim me numër protokolli Nr.1706/2022 përmes të cilit ankuesi është emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u obliguar Njëësia e Burimeve Njerëzore të ndërmarr veprimet për zbatimin e këtij vendimi.

Me datë 15.11.2022 ankuesi është njoftuar përmes emailit nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të MAPL-së, se Akt Emërimi është përgatitur dhe nënshkruar nga DBNJ, mirëpo në të njëjtën ditë ankuesi është njoftuar që të injoroj emailin paraparak për shkak që është bërë gabim teknik dhe do të njoftohet me kohë.

Ankuesi kundër mos zbatimit të Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 28.12.2022 ka parashtruar anekse me Nr. Port: 8524/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar që ankesa të aprovohet, të obligohet Njëësia e Burimeve Njerëzore e MAPL-së t'i lëshoj akt emërimin ankuesit sipas Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin për pozitë të kategorisë së mesë drejtuese nga data 06.08.2022 deri në nxjerrjen e Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin nga data 08.11.2022, deri në zbatimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 13.01.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Ministrinë të Administrimit të Pushtetit Lokal. Këshilli më datë 03.02.2023 për mesë e-mailit ka pranuar përgjigjën në ankesë nga Njëësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me provat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit bazuar në aktet e brendshme normative, me datë 08.02.2023 përmes vendimit me numër VK/2023 ankesën e ankuesit

A.nr.1299/2022 të datës 28.12.2022 i është vazhduar afatin vendimmarrës edhe për 10 (dhjetë) ditë, ditë punë për shkak të specifikave të lëndës dhe nevojës së shqyrtimit të mëtejme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 8524/2022 të datës 28.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim për avokatin e datës 26.08.2022; Akt emërim për nr.0/2 e datës 21.11.2011; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit për e datës 19.02.2013; Vendimit me numër protokollit Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022; Vendim i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Nr.08/140 e datës 05.04.2017; Vendim i lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Nr.10/102 e datës 07.05.2019; Ankesën me numër protokollit 5008/2022 të datës 29.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A.nr.741/2022 të datës 21.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim email i datës 19.12.2022; E-mail i datës 19.12.2022 nga znj.M.SH drejtuar Sh.L.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është *e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Vendimit A.nr.741/2022 të datës 21.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 ka bërë emërimin e ankuesit në pozitën "*Drejtor i Departamentit për Përformancë dhe Transparencë Komunale*"; në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal duke obliguar Njëjësinë e Burimeve Njerëzore të ndërmarr veprimet për zbatimin e këtij vendimi, mirëpo nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka ndonjë veprim për zbatimin e Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përveç emailit të datës 15.11.2022 kur ankuesi është njoftuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të MAPL-së, se Akt Emërimi është përgatitur dhe nënshkruar nga DBNJ, mirëpo në të njëjtën ditë ankuesi është njoftuar që të injoroj emailin paraprak për shkak që është bërë gabim teknik dhe do të njoftohet me kohë.

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas emailit të datës 11.11.2022 Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme që të shtyhet procedimi i transferimit të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Përformancë dhe Transparencë Komunale me arsyetimin që janë në proces të përgatitjes së rregullores së re dhe kjo pozitë nuk do të ekzistojë, ndërsa sipas emailit të datës 21.11.2022 Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore që Akt Emërimi nuk mund të nënshkruhet, këtë e ka ripërsëritur përmes emailit të datës 22.11.2022, ndërsa më datë 22.11.2022 Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në MAPL ka njoftuar Sekretaren e Përgjithshme që është duke e zbatuar ligjin dhe në rregulloren e brendshme aktuale kjo pozitë është e paraparë, si rezultat i kësaj më datë

23.11.2022 Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në MAPL përmes emailit ka kërkuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme se meqë Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar që akt emërimi mos të nënshkruhet, a ka obligim Njësia e Burimeve Njerëzore të bënë zbatimin e Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kolegji i Këshillit, marr parasysh rrethanat si më lartë dhe duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi, konstaton se sipas Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 për emërimin e ankuesit *"Drejtor i Departamentit për Përformancë dhe Transparencë Komunale"*, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vepruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenin 42 paragrafi 7, nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues si dhe sipas obligimit të Vendimit A.nr.741/2022 të datës 21.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht si rezultat i këtyre veprimeve Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit përkatës në rastin konkret e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është e obliguar që në veprimet në pajtim me paragrafin 4 të nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: *"Pas Vendimit nga Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publikë për emërimin e nëpunësit në institucionin përkatës, NJBNJ e institucionit i lëshon akt emërimin nëpunësit të emëruar"*, po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr.1706/2022 i datës 08.11.2022 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është i zbatueshëm në kuptim të nenit 51 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që përcaktohet se: *"1.Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij"*, sepse i njëjti ka filluar të prodhojë pasojat juridike për palët, po ashtu ky vendim ka qenë i ekzekutueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 144 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se vonesat për emërim të ankuesit në pozitën Drejtor i Departamentit për Përformancë dhe Transparencë Komunale, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave ligjore në fuqi si dhe kanë të bëjë me shkelje të ligjit materiale dhe parimeve të Shërbimit Civil të përcaktuara me dispozitat e nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-technikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*. Andaj meqë sipas Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka qenë e obliguar Njësia e Burimeve Njerëzore e MAPL-së të ndërmar veprimet juridike, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e MAPL-së është e obliguar që

ankuesit t'i lëshoj Akt Emërimin në pajtim me Vendimin me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në pajtim me paragrafin 4 të nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, kështu që pretendimi i ankuesit për emërim në këtë pozitë është i bazuara.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin për pozitë të kategorisë së mesë drejtuese nga data 06.08.2022 deri në nxjerrjen e Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kolegji i Këshillit, kontakton se sipas Vendimit A.nr.741/2022 të datës 21.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është obliguar Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë kompensimin e pagës në mënyrë retroaktiveve nga data 06.08.2022 në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese, rrjedhimisht Kolegji konstaton se nuk ka asnjë dëshmi që ankuesit i është bërë ky kompensim, andaj obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë kompensimin e pagës për ankuesin për pozitë të kategorisë së mese drejtuese nga data 06.08.2022 deri në kohën e nxjerrjes së Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Sa i përket pretendimit që të kompensohet nga data 08.11.2022 deri në zbatim të këtij vendimi për pozitën Drejtor i Departamentit për Përformancë dhe Transparencë Komunale, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky pretendim është i bazuar sepse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në pajtim me Vendimit me Nr.1706/2022 të datës 08.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka qenë e obliguar që ankuesin ta përfshirë në listën e pagave, rrjedhimisht ankuesit i përveç që i është mohuar e drejta për t'u pajisur me Akt Emërim të njëjtit i është mohuar e drejta për kompensim, andaj Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është i obliguar të bëjë zbatimin e këtij vendimi si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1299/2022

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik/MPB
- Arkivit të KPMSHCK-së

